



UNIVERSITETI SHETËTOR I TETOVËS
ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

Në bazë të rekomandimeve nga Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 15/2013), nenit 144 të Statutit të Universitetit Shtetëror të Tetovës, Këshilli i rektoratit në mbledhjen e mbajtur më 07.11.2013, solli:

UDHËZUES
për mënyrën dhe procedurën e përsëritjes së lëndëve pas përfundimit të
studimeve dhe dhënies së certifikatës dhe diplomës

Neni 1

Me këtë udhëzues rregullohet mënyra dhe procedura për përsëritjen e provimeve të lëndëve nga ana e personave të cilët kanë përfunduar studimet dhe kanë fituar thirrje profesionale, respektivisht shkencore përkatëse dhe të cilëve iu është dhënë certifikatë dhe diplomë.

Neni 2

Të drejtë për përsëritjen e provimeve kanë të gjithë personat që kanë arritur mesatare prej 7,5 nga studimet e ciklit të parë dhe dytë pas përfundimit të studimeve, në institucionin përkatës të arsimit të lartë (universitet, institut).

Përsëritja e provimeve lejohet vetëm për numër të caktuar të lëndëve, por jo tepër se pesë lëndë.

Përsëritja e provimit në një lëndë është e mundshme vetëm një herë.

Nëse nota e përsëritur është jokaluese e njëjta nuk numërohet si lëndë e përsëritur dhe nuk mund të ripërsëritet.

E drejta për përsëritjen e provimeve në lëndët e caktuara lejohet vetëm njëherë.

Kërkesa për përsëritjen e provimeve dhe dokumentacioni

Neni 3

Personat të cilët i plotësojnë kushtet ligjore, parashetrojnë kërkesë në arkivin e universitetit, drejtuar **dekanit të fakultetit**, respektivisht drejtorit të institutit për përsëritjen e provimeve në lëndë të caktuara.

Kërkesën e arkivuar, kandidati e dorëzon te shërbimi studentor përkatës i fakultetit, respektivisht programit studimor që kanë diplomuar.

Shërbimi studentor për kandidatët që aplikojnë për përsëritjen e provimeve krijojnë dosje të veçantë.

Dosja e re e krijuar udhëhiqet me numrin e dosjes që kandidati ka pasur gjatë studimeve.

Kandidati ka të drejtë të përsëris provimet në institucionin e arsimit të lartë, ku i ka dhënë provimet e lëndëve për të cilat kërkon përsëritjen e tyre.

Neni 4

Kërkesa parashtrohet me formularë të veçantë, e cila përmban: emrin, emrin e njërës prind dhe mbiemrin, datëlindjen, vendin e lindjes, adresën e vendbanimit, emri i fakultetit dhe programit studimor që ka përfunduar, numri i dosjes nga studimet, lëndët për të cilët kërkon përsëritjen e provimit, data e diplomimit, numri i diplomës, nota mesatare, numri i telefonit, e-mail adresa.

Neni 5

Me kërkesën, kandidati e dorëzon edhe dokumentacionin në vijim:

- Fotokopje të noterizuar të certifikatës së provimeve të dhëna;
- Fotokopje e noterizuar e certifikatës së diplomës
- Diploma origjinale për përfundimin e studimeve;
- Kopje të letërnjoftimit;
- 2 fotografi.

Kandidatit të cilit i pranohet kërkesa, i jepet indeks i ri.

Kandidati dorëzon edhe deklaratë të verifikuar në noter, për numrin e provimeve të cilat do i përsëris dhe në cilin institucion të arsimit të lartë (universitet, fakultet, institut) në Republikën e Maqedonisë.

Neni 6

Kandidati kërkesën mund të parashtrorë më së voni 1 muaj para mbajtjes së afatit të rregullt të provimeve.

Vendimi për lejimin e përsëritjes së provimeve, ankesa dhe organizimi

Neni 7

Nëse janë të plotësuar kushtet ligjore, dekani, respektivisht drejtori, në afati prej 8 ditësh nga pranimi i kërkesës sjell vendim për lejimin e përsëritjes së provimeve për lëndët e caktuara.

Në vendim theksohet se kandidati i plotëson kushtet e rregulluara me ligj dhe theksohen lëndët për të cilat i jepet leje ti përsëris dhe mësimdhënësit të cilët do të mbajnë provimin, respektivisht përsëritjen e provimit.

Vendimi bëhet në katër kopje, dhe atë dorëzohet: arkivit, kandidatit, shërbimit studentor dhe dekanit.

Neni 8

Vendimi i dorëzohet kandidatit drejtpërdrejtë në dorë, me çka dita e dorëzimit llogaritet dita e pranimit ose dërgohet në adresën e kandidatit.

Neni 9

Nëse dekani, respektivisht drejtori, sjell vendim me të cilën refuzohet në tërësi ose pjesërisht kërkesa, kandidati ka të drejtë ankese deri te këshilli mësimor-shkencor.

Ankesa mund të parashtrohet në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 10

Përsëritja e provimit realizohet në afatet e caktuara të provimeve.

Neni 11

Në një afat të caktuar për provime, mund të paraqiten jo më tepër se 2 lëndë.

Neni 12

Orari për mbajtjen e provimeve që përsëriten shpallet në listë të veçantë, për kandidatët e caktuar.

Provimet në lëndët e përsëritura organizohen veçmas ose me studentët tjerë që i nënshtrohen provimit përkatës, nga mësimdhënësit e caktuar.

Neni 13

Përmbajtjen dhe literaturën për lëndën e cila përsëritet, e rregullon mësimdhënësi bartës i lëndës në afat prej 7 ditëve nga dita e sjelljes së vendimit, në të cilin është i caktuar bartës i lëndës dhe në formë të shkruar ia dorëzon kandidatit dhe dekanit, respektivisht drejtorit.

Neni 14

Provimet e përsëritura shënohen në indeks dhe në fletëparaqitje, me vërejtje se lënda është përsëritur, data e përsëritjes së provimit, emrin personal dhe nënshkrimin e mësimdhënësit dhe të dhëna tjera të nevojshme që i përmban indeksi dhe fletëparaqitja.

Për secilën lëndë të përsëritur mbushet raport dhe i njëjti nënshkruhet nga mësimdhënësi.

Certifikata, diploma shtesë dhe diploma

Neni 15

Për lëndën e përsëritur, respektivisht lëndët e përsëritura, kandidatit i lëshohet certifikatë, e cila përmban të dhënat, notat dhe elemente të tjera të lëndëve të përsëritura.

Në bazë të kësaj certifikate që përmban lëndët e përsëritura dhe certifikatës së provimeve të dhëna, kandidatit i lëshohet certifikatë e re për provimet e dhëna, respektivisht për thirrjen profesionale, respektivisht shkencore të fituar.

Certifikata e re, në pikën 2 të këtij neni, krahas lëndëve tjera, i përmban edhe lëndët për të cilat është realizuar përsëritja e provimit dhe nota e re e mesatares së suksesit.

Certifikata duhet të përmbajë vërejtje për lëndët ku janë përsëritur provimet dhe notën mesatare të arritur.

Certifikata jepet në formën e cila është përdorur në kohën e diplomimit të kandidatit.

Certifikata udhëhiqet me numër të njëjtë (numër dosje) si certifikata e fituar në momentin e diplomimit.

Neni 16

Kandidatit i jepet shtesë diplome, e cila do të përfshijë edhe notat nga përsëritja e provimeve dhe nota e re mesatare e arritur.

Neni 17

Në librin amzë të studentëve të diplomuar, në rubrikën për vërejtje, theksohet se kandidati ka përsëritur provime dhe shkruhet nota e re mesatare.

Neni 18

Deri në dhënien e diplomës shtesë, lëshohen vetëm certifikatat sipas nenit 15 të këtij udhëzuesi.

Kandidatit të cilët kanë diplomuar sipas procedurave kur nuk është paraparë diplomë shtesë, i lëshohet vetëm certifikata sipas nenit 15 të këtij udhëzuesi.

Në diplomën origjinale e cila është lëshuar për kandidatin për studimet e kryera, vendoset vulë në formë drejtkëndëshi në anën e prapme të diplomës, me tekst: *Bartësi i kësaj diplome me numër dosje _____ka përsëritur ___ provime dhe ka arritur mesataren e suksesit prej __,___.*

Kjo vulë vërtetohet me vulën e universitetit dhe nënshkruhet nga dekani i fakultetit, respektivisht institutit dhe e njëjta arkivohet për kohën aktuale të lëshimit.

Shpenzimet

Neni 19

Shpenzimet për paraqitjen e provimeve, indeksin e ri sipas nenit 4, certifikatën e notave sipas nenit 14 dhe diplomën shtesë sipas nenit 15, kandidati i mbulon vetë sipas tarifave të caktuara aktuale me çmimoren e universitetit.

Neni 20

Pjesë të këtij udhëzuesi janë: kërkesa sipas nenit 4, deklarata e nenit 5, pika 3, vendimi i nenit 7, certifikatat e nenit 15 dhe vula për përsëritjen e provimeve.

Neni 21

Ky udhëzues hynë në fuqi nga dita e miratimit të tij.

Rektori
Prof.dr Vullnet Ameti